


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Maj 2024

Tiranë, më 10 Qershor 2024: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Maj 2024, arriti 116,8 kundrejt muajit Dhjetor 2020.


Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2024 është 2,2 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 4,7 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2024, krahasuar me Prill 2024 është - 0,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Maj është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,69 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,42 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” ndikuan me +0,28 pikë përqindje, çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,15 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,14 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,11 pikë përqindje secili, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,08 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,07 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Transporti” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,06 pikë përqindje secili.

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Maj 2023, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 3,7 % secili, “Veshje dhe këpucë” me 3,2 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,1 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 2,5 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 2,4 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shërbimi arsimor” me 2,2 % secili, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,9 %, “Shëndeti” me 1,7 %, “Transporti” me 1,1 % dhe “Komunikimi” me 0,1 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” patën një rritje me 4,6 %, pasuar nga nëngrupet “peshk” me 4,1 %, “qumësht, djathë dhe vezë” u rritën me 3,6 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 2,9 %, “mish” me 2,3 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Prill 2024, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1,1 %, pasuar nga “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,7 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” shënuan rritje me 0,6 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Veshje dhe këpucë” me 0,2 % secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, “Komunikimi”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23	12-23	01-24	02-24	03-24	04-24	05-24
	Gjithsej	100	114,3	114,0	113,8	114,5	115,3	115,4	115,3	115,8	116,4	116,8	117,3	117,1	116,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,6	129,0	127,4	126,7	127,2	128,7	128,7	128,1	129,6	131,2	132,2	133,4	132,5	131,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	110,3	110,3	110,8	110,8	111,0	111,2	111,2	112,4	112,5	112,6	112,9	113,4	113,6
3	Veshje dhe këpucë	3,8	105,8	106,2	106,7	106,6	107,5	108,1	108,2	108,7	108,9	108,9	108,8	108,9	109,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,0	105,4	105,4	105,4	106,6	106,6	106,7	106,8	107,5	107,5	107,6	107,7	107,6	107,7
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	110,7	111,0	111,2	111,6	112,0	112,8	112,5	112,6	113,4	113,8	113,9	114,2	114,8
6	Shëndeti	3,5	102,2	102,3	102,5	102,7	103,0	103,1	103,1	103,2	103,5	103,9	103,9	104,0	104,0
7	Transporti	6,2	109,3	109,0	109,8	112,8	114,3	114,6	114,3	111,8	111,4	111,2	111,6	111,8	110,5
8	Komunikimi	3,0	104,9	104,9	104,9	104,9	105,0	105,0	104,9	104,9	104,9	104,9	104,9	104,9	105,0
9	Argëtim dhe kulturë	2,2	109,9	111,8	110,8	110,9	112,3	112,3	111,3	111,3	111,4	111,6	112,0	113,2	113,9
10	Shërbimi arsimor	3,3	103,0	103,0	103,0	103,2	104,9	105,2	105,2	105,2	105,2	105,1	105,1	105,1	105,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,6	111,4	111,8	112,5	113,0	113,0	113,3	113,3	113,5	113,7	113,7	113,8	114,0	114,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	105,0	105,2	105,4	105,6	105,9	105,9	106,0	106,6	106,8	107,2	107,3	107,4	107,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-23/05-22	06-23/06-22	07-23/07-22	08-23/08-22	09-23/09-22	10-23/10-22	11-23/11-22	12-23/12-22	01-24/01-23	02-24/02-23	03-24/03-23	04-24/04-23	05-24/05-23
	Gjithsej	4,7	4,5	4,2	4,0	4,1	3,8	3,9	4,0	3,4	2,6	2,3	2,1	2,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	10,0	10,3	9,0	7,8	7,9	7,4	7,1	6,7	5,3	2,7	2,0	1,5	1,9
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,7	3,7	3,8	3,2	3,0	3,6	3,5	4,3	3,9	3,7	3,3	3,3	3,1
3	Veshje dhe këpucë	4,2	4,4	4,3	4,4	3,2	3,2	2,9	3,0	3,3	3,4	3,3	3,4	3,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	2,2	2,1	1,3	2,3	2,1	1,6	1,9	2,6	2,3	2,4	2,4	2,3	2,2
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	6,2	6,0	5,9	5,4	5,2	4,8	4,6	5,0	4,7	4,2	3,5	3,7
6	Shëndeti	1,4	1,2	1,1	1,3	1,4	1,1	1,0	1,2	1,6	1,9	1,9	1,7	1,7
7	Transporti	-12,3	-16,2	-12,4	-10,0	-7,2	-8,3	-4,0	-3,3	-4,3	-1,6	-0,3	1,0	1,1
8	Komunikimi	1,2	1,4	1,2	1,1	1,1	1,1	0,5	0,3	0,3	0,3	0,2	0,0	0,1
9	Argëtim dhe kulturë	6,9	10,3	9,5	3,9	4,9	7,6	6,0	5,4	5,0	4,9	3,8	4,4	3,7
10	Shërbimi arsimor	2,2	2,2	2,0	2,2	2,3	2,9	2,6	2,3	2,2	2,2	2,3	2,2	2,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,0	4,8	5,0	5,0	4,7	4,8	4,3	4,4	4,0	3,8	3,5	3,2	2,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,0	4,0	3,7	3,7	3,1	2,9	2,8	3,4	3,4	3,5	3,3	2,7	2,5

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23	12-23	01-24	02-24	03-24	04-24	05-24
	Gjithsej	-0,3	-0,3	-0,1	0,6	0,7	0,1	-0,2	0,5	0,5	0,3	0,4	-0,2	-0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-1,2	-1,2	-0,6	0,4	1,1	0,0	-0,4	1,1	1,3	0,7	1,0	-0,7	-0,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,0	0,4	0,0	0,2	0,2	0,0	1,0	0,1	0,1	0,2	0,5	0,2
3	Veshje dhe këpucë	0,5	0,4	0,4	-0,1	0,8	0,5	0,2	0,5	0,2	-0,1	0,0	0,1	0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,2	0,0	0,0	1,1	0,0	0,1	0,1	0,6	0,0	0,1	0,1	0,0	0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,3	0,3	0,2	0,3	0,4	0,6	-0,2	0,1	0,7	0,4	0,1	0,2	0,5
6	Shëndeti	0,0	0,0	0,2	0,2	0,3	0,0	0,0	0,1	0,3	0,4	0,0	0,1	0,0
7	Transporti	-1,2	-0,3	0,7	2,8	1,3	0,3	-0,3	-2,1	-0,4	-0,2	0,3	0,2	-1,1
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1
9	Argëtim dhe kulturë	1,2	1,8	-0,9	0,1	1,2	0,0	-0,9	0,0	0,1	0,2	0,4	1,1	0,6
10	Shërbimi arsimor	0,1	0,0	0,0	0,2	1,7	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,9	0,3	0,6	0,4	0,0	0,2	0,0	0,2	0,2	0,0	0,1	0,2	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,4	0,2	0,2	0,2	0,3	0,0	0,1	0,5	0,2	0,3	0,1	0,1	0,1

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2022.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.